



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Njesia Org. Org. Jedin Org. Unit	02	Nr. Prot. Br. Prot Prot.No:	3880
Nr. i faqesve Broj stranica No. pages	2	Data: Datum: Date:	29.08.25
PRISHTINE A			NO. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy

Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe në pajtim me nenin 12 të Rregullores (MF) Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, merr këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJE TË THIRRJES PUBLIKE PËR OJQ

1. Shpallet Thirrja Publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për projekte të organizatave jo-qeveritare në fushën e Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtritshme dhe të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve në fushën e Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtritshme si dhe të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) do të bëhet nga buxheti i Ministrisë së Ekonomisë, kodi i organizatës buxhetore 213, në kuadër të kategorisë ekonomike Subvencione dhe Transfere në kuadër të programit/nënprogramit 11413. Shuma e përgjithshme e ndarë për këtë thirrje publike është 42,337.00 (dyzet e dy mijë e treqind e tridhjetë e shtatë) euro.
3. Mjetet nga pika 2 e këtij Vendimi do të ndahen në pajtim me thirrjen publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, dhe sipas dokumentacionit për zbatim të thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Për implementimin e thirrjes publike nga pika 1 e këtij Vendimi, do të zbatohen dispozitat e Rregullores përkatëse mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
5. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës 4 të këtij vendimi përfshin:
 - 5.1. Teksti i thirrjes publike;
 - 5.2. Udhëzimet për aplikuesit;
 - 5.3. Formularët e aplikimit;
 - 5.4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve;
 - 5.5. Format për raportimin e zbatimit të projektit.
6. Formularët e aplikimit janë:
 - 6.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit;
 - 6.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit;
 - 6.3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta;
 - 6.4. Deklarata e partneritetit (nëse është e aplikueshme);

- 6.5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike;
- 6.6. Forma e deklaratës mbi aktivitetet e përshkruara të programit/projektit.
7. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të sipas paragrafit 1 të këtij Vendimi janë:
- 7.1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit;
- 7.2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin;
- 7.3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit.
8. Thirrja publike për ofrimin e mbështetjes financiare dhe dokumentacioni përkatës për aplikim do të publikohen në ueb-faqen e Ministrisë së Ekonomisë <https://me.rks-gov.net/>.
9. Thirrja Publike do të implementohet nga Komisioni përkatës vlerësues në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë në pajtim me Rregulloren (MF) Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 29.08.2025

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Arkivit.

Leonita Shabani Mullarama

Sekretare e Përgjithshme

